

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Viti i ri shkollor nis me ndryshime, “Pas Shkolle” shtrihet në 408 shkolla dhe shtohen masat e sigurisë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/sociale/viti-i-ri-shkollor-nis-me-ndryshime-pas-shkolle-shtrihet-ne-408-shkolla--i585917
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 06:28:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 07:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	dc0204598c10cf65b354e0d9e326e1dadcfcb91d0a3b963ef09fbc08f840a
TEKSTI	260a10660a51064e67726863ef3cefd0ff6aa009ef275741891fb760eba55350
PAMJA	05c33088c510af1243a11996be8bdda09d5b6b13fa2e7b34ae96c587b76f2df1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	06dcae225bd9630b302371e30c712ff8895f38c645cef91af9c77ab091437352
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/06dcae225bd9630b302371e30c712ff8895f38c645cef91af9c77ab091437352>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 English

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 English



ie Rama uron nxenesit per nishjen e vitit te ri shkollor: Shkolla te rilindura me standarde te reja Viti i ri shkollor/ Ministrja Kumbaro uron nxenesit: Me shume kushte bashk fundit

Viti i ri shkollor nis me ndryshime, “Pas Shkollë” shtrihet në 408 shkolla dhe shtohen masat e sigurisë



14 Shtator 2026, 09:10Sociale TEMA



Viti i ri shkollor 2026–2027 ka nisur në të gjithë vendin, me mijëra nxënës që rikthehen në bankat e shkollës dhe rreth 25 mijë fëmijë që nisin për herë të parë klasën e parë.

Viti i ri shkollor shoqërohet me një sërë masash dhe ndryshimesh në arsimin parauniversitar, me fokus te përmirësimi i infrastrukturës, forcimi i sigurisë në shkolla, zgjerimi i shërbimit psiko-social dhe krijimi i më shumë mundësive për aktivitete jashtë orarit mësimor.

Në vitin shkollor 2026–2027, 53 shkolla të reja ose të rehabilituara hapin dyert për nxënësit. Paralelisht, janë miratuar edhe 39 projekte të tjera për rikonstruksionin e shkollave, duke vijuar investimet në përmirësimin e infrastrukturës arsimore.

Ndërhyrjet në institucionet arsimore synojnë krijimin e kushteve më të mira për zhvillimin e procesit mësimor, ndërsa në shkolla janë parashikuar edhe ambiente dhe pajisje të reja, përfshirë laboratorët inteligjentë dhe “smartlab”-et.

Gjatë vitit shkollor nxënësit do të kenë mundësi të angazhohen edhe në aktivitete të ndryshme akademike dhe krijuese, përfshirë festivalin e shkencës, olimpiadat, konkurset e gjuhës dhe aktivitetet muzikore.

Siguria është një nga prioritetet kryesore të këtij viti shkollor. Në institucionet arsimore në të gjithë vendin do të jenë në shërbim të nxënësve mbi 400 oficerë sigurie, të cilët do të veprojnë sipas protokolleve dhe standardeve të përditësuara. Në kuadër të forcimit të masave të sigurisë, 20 shkolla në Tiranë janë përfshirë në projektin pilot “Smart City”.

Në këto shkolla parashikohet përdorimi i kamerave inteligjente, si pjesë e masave të shtuara për monitorimin dhe sigurinë e ambienteve shkollore. Krahas masave të sigurisë, gjatë vitit shkollor 2026–2027 është fuqizuar edhe shërbimi psiko-social.

Në shkollat e vendit do të jenë të pranishëm 900 psikologë dhe punonjës socialë, të cilët do të ofrojnë mbështetje për nxënësit dhe do t’u përgjigjen nevojave të tyre sociale dhe emocionale. Një nga risitë kryesore të këtij viti është zgjerimi i programit “Pas Shkollë”.

Pas fazës pilot të zhvilluar në Tiranë gjatë vitit të kaluar, programi këtë vit shtrihet në 408 shkolla në të gjithë Shqipërinë.

Programi synon të krijojë mundësi që nxënësit të qëndrojnë edhe pas përfundimit të orarit mësimor, duke u angazhuar në aktivitete të ndryshme.

Në kuadër të programit do të zhvillohen klube dhe aktivitete në fusha të tilla si arti, muzika, teatri, sporti, zejet dhe aktivitete të tjera krijuese.

Nxënësit dhe prindërit do të informohen gjatë javëve të para të vitit shkollor për mënyrën e funksionimit të programit dhe për mundësitë e përzgjedhjes së aktiviteteve.

Për zhvillimin e tyre është hapur edhe thirrja për trajnerë. Në këtë proces mund të përfshihen mësues, mësues në pension, artistë, artizanë dhe profesionistë të fushave përkatëse.

Të dhënat paraprake për vitin e ri shkollor tregojnë gjithashtu një lëvizje të nxënësve nga arsimi jo-publik drejt sistemit publik.

Rreth 1,200 nxënës janë transferuar nga shkollat jo-publike në shkollat publike për këtë vit shkollor. Kjo lëvizje përbën një nga treguesit e ndryshimeve në strukturën e regjistrimeve për vitin 2026–2027.

Përveç procesit mësimor, gjatë vitit të ri shkollor pritet të ketë një fokus më të madh edhe te zhvillimi i aktiviteteve jashtëshkollore.

Nxënësit do të kenë mundësi të marrin pjesë në olimpiada, konkurse, aktivitete shkencore, kulturore dhe artistike, ndërsa programi “Pas Shkolle” synon të zgjerojë këto mundësi në 408 shkolla.

Në këtë kuadër, shkollat synojnë të shërbejnë jo vetëm si ambiente për zhvillimin e mësimin, por edhe si hapësira ku nxënësit mund të zhvillojnë aftësitë e tyre në fusha të ndryshme.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Viti i ri shkollor/ Ministrja Kumbaro uron nxënësit: Më shumë kushte bashkëkohore, siguri, dije dhe zbavitje në programin "Pas Shkolle"

08:10 Sociale

Akuzat për kushtet e sportistëve të 'EUSA Combat 2026', Gonxhja: Fotot nuk janë nga ambientet ku qëndrojnë

delegacionet

18:10 Sociale

Ndryshon ligji për legalizimet, kushte për zonat ku parashikohet ndërtimi i pallateve

13:50 Sociale / 5 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.